

Në bazë të nenit 40-j dhe nenit 40-ll paragrafi 4 të Ligjit për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 104/2009 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 14/20, 174/21, 298/21, 67/22 dhe 65/23), dhe në lidhje me nenin 22 paragrafi (1) nën paragrafi 6, paragrafi (5) dhe paragrafi (8) të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19 dhe 14/20), neni 22, neni 23 dhe neni 24 i Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005; 106/2008; 161/2008; 114/2009; 130/2009; 50/10; 52/10; 124/10; 47/11; 11/12; 39/12; 13/13; 25/13; 170/13; 187/13; 113/14; 20/15; 33/15; 72/15; 129/15, 27/16 dhe 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/2019, 267/2020, 151/21, 288/21 dhe 111/23) dhe neni 3 i Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 01-566/1 nga 29.01.2021 dhe Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 01-4692/1 nga 14.11.2022 dhe nr. 01-4210/1 nga 30.08.2023, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall:

KONKURS PUBLIK numër 01/2024 **për punësimin e 4 (katër) këshilltarëve të veçantë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në kohë të caktuar**

Për nevojat e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të kryerjes së detyrave të veçanta të punës, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs publik për punësimin e një këshilltar të veçantë për një kohë të caktuar (deri në përfundimin e mandatit të Kryetarit), për vendin e punës si vijon:

1. Këshilltar i veçantë për planifikim strategjik - 1 (një) realizues në Kabinetin e Kryetarit të Kuvendit;

Kandidati duhet të plotësojë këto kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- në mënyrë aktive ta zotërojë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidati përveç kushteve të përgjithshme nevojitet t'i plotësojë edhe këto kushte të posaçme:

- Të ketë të përfunduar arsimin e lartë me së paku 240 kredi sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1, Shkenca Ekonomike ose Shkenca Organizative (menaxhment);
- Me ose pa përvojë pune;
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane) dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Për nevojat e nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të kryerjes së detyrave të veçanta të punës, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs publik për punësimin e 2 (dy) këshilltarëve të veçantë për një kohë të caktuar (deri në përfundimin e mandatit të nënkryetarëve), për vendet e punës në vijim:

2. Këshilltar i veçantë i nënkryetarit të Kuvendit për çështje ekonomike dhe juridike-politike - 2 (dy) realizues për nevojat e nënkryetarëve të Kuvendit;

Kandidati duhet të plotësojë këto kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- në mënyrë aktive ta zotërojë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidati përveç kushteve të përgjithshme nevojitet t'i plotësojë edhe këto kushte të posaçme:

- Të ketë të përfunduar arsimin e lartë me së paku 180 kredi sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1; Shkenca ekonomike dhe juridike
- Me ose pa përvojë pune;
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane) dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Për nevojat e sekretares së përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të kryerjes së detyrave të veçanta të punës, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs publik për punësimin e 1 (një) këshilltar të veçantë për një kohë të caktuar (deri në përfundimin e mandatit të sekretares së përgjithshme), për vendin e punës si vijon:

3. Këshilltar i veçantë për bashkëpunim me organizata joqeveritare dhe qytetare dhe menaxhim me projekte - 1 (një) realizues për nevojat e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit;

Kandidati duhet të plotësojë këto kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- në mënyrë aktive ta zotërojë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidati përveç kushteve të përgjithshme nevojitet t'i plotësojë edhe këto kushte të posaçme:

- Të ketë të përfunduar arsimin e lartë me së paku 240 kredi sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1, Mbrojtje ose siguri;
- Me ose pa përvojë pune;
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët i plotësojnë kushtet e theksuara. Kandidatët me kërkesën duhet të dorëzojnë për plotësim të kushteve të theksuara në konkursin publik, në formë origjinale ose kopje të verifikuar në noter dhe atë:

- dëshmi për shtetësi;
- dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (certifikatë mjekësore jo më e vjetër se një vit e lëshuar nga mjek specialist në mjekësinë e punës);

- dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (vërtetim nga Regjistri Qendror se nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje, ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më i vjetër se gjashtë muaj);

- certifikatë/diplomë për shkallën e përfunduar të arsimimit;
- dëshmi për njohje aktive të një nga tre gjuhët më të përdorura në Bashkimin Evropian;
- dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe

- biografi e shkurtër me kontakt telefoni dhe adresë detyrimisht të theksuar.

Orari i kohës së punës:

- Orë pune në javë: 40.
- Orari i punës: Nga 8:30 deri më 16:30.
- Ditë pune: Nga e hëna deri të premten.

Si kushte të posaçme për punë në kabinet parashihen: punë gjatë pushimit javor, punë gjatë festave të përcaktuara me ligj, me qëllim të kryerjes së punëve urgjente dhe të pa prolonguara.

Shuma në para të rogës neto themelore për vend pune arrin 63.906,00 denarë.

Për kandidatin e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për orar të caktuar. Punësimi i këshilltarit të veçantë zgjat deri në përfundim të mandatit të funksionarit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 3 (tri) ditë pune, duke llogaritur nga dita e publikimit të konkursit. Kushtet e theksuara në konkurs, kandidatët duhet t'i plotësojë në momentin e fletëparaqitjes. Fletëparaqitja për konkurs mund të merret nga ueb-faqja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. www.sobranie.mk

Aplikimet që nuk janë në kohë dhe janë të paplota nuk do të merren parasysh.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut do të bëjë zgjedhje në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie të punës. Procedurën për punësim sipas këtij konkursi publik e zbaton Komisioni për Përzgjedhje për punësim pas konkursit publik.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në zaf të mbyllur në Zyrën e protokollimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose me postë në adresën e mëposhtme:

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut rr. "11 Tetori" nr.10, Shkup, me referencë: "Konkurs për këshilltar të veçantë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Fletëparaqitjet të dorëzuara përmes postës, duhet të jenë të pranuar në Zyrën e Protokollimit të Kuvendit, më së voni deri në ditën e përfundimit të afatit të konkursit publik.